

VENDIM
Nr.718, datë 18.11.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 KV, NË SUKTH-SALLMONE, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, në Sukth-Sallmone, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, për sipërfaqen prej 4252 (katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) me tokë bujqësore, arë, në shumën e përgjithshme prej 7 653 600 (shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekësh, sipas masës së përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ky fond të përballët nga KESH, sh.a.-ja, zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 170 000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga KESH, sh.a.-ja, si kërkuesi për shpronësim.

6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda muajit nëntor 2005 dhe të përfundojë brenda vitit 2005.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/20 KV SUKTH-SALLMONE, DURRËS"

RRETHI : DURRËS
KOMUNA: XHAZOTAJ, FSHATI SALLMONE

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : **Tokë Bujqësore Arë**

Nr.	Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Faqe	Sip. në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	IBRAHIM	MUÇA	Tokë Bujqësore	3255	87/71	105	400	1800	720.000
2.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/82	120	106	1800	190.800
3.	FADIL	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/97	140	421	1800	757.800
4.	FADIL	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/74	115	220	1800	396.000
5.	FIQIRI	DOMI	Tokë Bujqësore	3255	87/91	124	530	1800	954.000
6.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/94	127	695	1800	1.251.000
7.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/83	121	625	1800	1.125.000
8.	BEKTASH	DRIZA	Tokë Bujqësore	3255	87/88	107	625	1800	1.125.000
9.	PETRIT	MEMOÇI	Tokë Bujqësore	3255	87/86	112	425	1800	765.000
10.	FERIK	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/77	117	205	1800	369.000
Totali							4.252		7.653.600

Sqarime : Shpenzime procedurale: Publikime 170.000 (njëqindeshatëdhjetëmijë) lekë.

Vlera totale e shpronësimit = 7.653.600+ 170.000= 7.823.600 (shtatëmilion e tetëqindenjëzetëetremijë e gjashtëqind) lekë.